



**Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet
Institutit Helen të Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine të Venecias
dhe
Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë**

Presidenti i Institutit Helen të Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine në Venecia dhe Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë,

Të vetëdijshëm për lidhjet shumëpalëshe që bashkojnë Greqinë dhe Shqipërinë nga pikëpamja shkencore, arsimore, kulturore dhe gjuhësore;

Duke pranuar se institucionet e tyre përfaqësojnë grupime ekselence në fushën akademike, kulturore dhe sociale përsa i përket studimeve, kërkimit dhe organizatave kulturore që lidhen me fushat e tyre përkatëse të kërkimit;

Duke pranuar se bashkëpunimi i përzemërt dhe efektiv midis dy organizatave tashmë ka filluar;

Duke synuar të vazhdojnë të luajnë një rol aktiv duke ndjekur linjën e praktikave të mira dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë në çdo mënyrë të mundshme;

kanë vendosur të bashkëpunojnë si në vijim

Memorandum Bashkëpunimi:

1. Instituti Helen i Studimeve Bizantine dhe Post-Bizantine në Venecia dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në Tiranë do të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët, si në aspektin e kërkimit akademik dhe përhapjes kulturore, ashtu edhe pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore, urbane dhe artistike në fushat përkatëse të kërkimit.

Në veçanti, temat kryesore të bashkëpunimit do të jenë:

- Bashkëpunimi shkencor për çështjet e bibliotekomisë, arkivimit dhe organizimit të bibliotekave, kërkimit dhe studimit të dorëshkrimeve, kodikëve dhe dokumenteve, si dhe botimeve të vjetra (paleotipe), si dokumentimi, promovimi, shpëtimi dhe digjitalizimi i materialit të vlefshëm dhe sigurimi i aksesit të tij nga komuniteti shkencor;

- Çështjet historike, arkivore, gjuhësore, letrare, artistike, filozofike dhe në përgjithësi çdo aspekt i shkencave humanitare, që bien në fushën e përbashkët të kulturës dhe veprimtarisë së dy institucioneve;
- Pjesëmarrje e përbashkët në programe akademike dhe shkencore europiane ose ndërkombëtare, bashkëorganizimi i ekspozitave dhe konferencave shkencore ndërkombëtare ose dypalëshe, si dhe botime të përbashkëta;
- Marrëdhëniet, rrugët e përbashkëta ose divergjente, midis Greqisë dhe Shqipërisë nga kohët e lashta deri në ditët e sotme;
- Prania e Greqisë intelektuale në Shqipëri si dhe prania e Shqipërisë intelektuale në Greqi, në periudhën moderne.
- Është e mundur të shtohen fusha të tjera interesi, për të cilat do të bien dakord ndërmjet dy Palëve.

2. Bashkëpunimi do të zhvillohet në forma të ndryshme. Konkretisht:

- Iniciativa të përbashkëta shkencore dhe kulturore, si konferenca, ngjarje, ekspozita, prezantime, botime, etj.;
- Shkëmbimi i botimeve shkencore për bibliotekat përkatëse;
- Lehtësimi i punës së studiuesve ose vizitorëve nga institucionet mikpritëse;
- Bashkëpunim, ndihmë dhe informacion logjistik për akomodimin;
- Prezantimi i Palës tjetër në strukturat administrative, si dhe në shoqata të tjera shkencore dhe kulturore që merren me çështje me interes të përbashkët;
- Shkëmbimi i praktikave të mira.

3. Ky Memorandum Bashkëpunimi nuk ka datë skadimi, përveç rastit kur njëra nga dy Palët heq dorë shprehimisht duke i dërguar një njoftim me shkrim Palës tjetër.

4. Ky memorandum është hartuar në gjuhën angleze, greke dhe shqipe. Konsiderohet zyrtar pasi të nënshkruhet.

Tiranë, 25 nëntor 2022


Piro Misha

**Drejtor
Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë**



Vasileios Koukousas

**Presidenti i Institutit Helene të Studimeve
Bizantine dhe Post-Bizantine të Venecias**



820
25/11/2022